



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:153574
Datë: 31.08.2022
Numri i dokumentit: 03375413

C.nr.1041/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Mirjeta Shala, e me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kaltrina Halilaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit P. N. nga fshati . . ., komuna e Gjakovës, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari Dardan Morina, avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,713.80.-€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesorë publik, në prani të autorizuarit të paditësit e në mungesë të palës së paditur, me datën 26 gusht 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditësit P. N. nga komuna e Gjakovës dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, që paditësit të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 19% të pagës bazë për 44 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 31.12.2020, (për çdo muaj shumën nga 38.95 euro) të ia paguajë shumën prej 1,713.80.-€ (njëmijë e shtatëqind e trembëdhjetë euro e tetëdhjetë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 13.07.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditësit të ia paguajë shumën prej 259.00.-€, në afat prej 7 ditësh nga pranimit i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit P. N. nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarit të saj av. Dardan Morina, avokat në Prizren, në këtë gjykatë me datën 13.07.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune si mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët Lleshi” në fshatin . . ., Komuna e Gjakovës, ku të njëjtit për periudhën

kohore prej datës 18.04.2017 deri me datë 31.12.2020, për 44 muaj, i ka takuar e drejta e kompensimit për 19% të vlerës së pagës bazë, bazuar në nivelin e shkollimit, e kjo bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017, por që deri më tash nuk është kompensuar. I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 26.08.2022 ka dorëzuar parashtrësën me të cilën ka precizuar lartësinë e kërkesëpadisë, duke e zvogëluar të njëjtën, ashtu që në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, për paditësin e lartcekur ka kërkuar shumën prej 1,713.80 euro.

Në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj të cilën e ka precizuar me parashtrësë e të cilën e ka dorëzuar drejtpërdrejtë në seancë, në të cilën faktikisht kërkesë padia e paditësit ka të bëjë me zvogëlimin e lartësisë së saj në raport me kërkesë padinë e kërkuar në padinë fillestare. Me qëllim të vërtetimit të fakteve të theksuara në padi gjegjësisht fakti se paditësi është i punësuar pranë Institucionit shkollor SHFMU “Dëshmorët Lleshi” në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës. Në fjalën përfundimtare i njëjti ka deklaruar se pas administrimit të provave në këtë çështje kontestimore është vërtetuar baza juridike e padisë e cila gjen zbatim në kontratën kolektive të arsimit të Kosovës të vitit 2017, Ligjit të Punës dhe Udhëzimit Administrativ me numër 05/2017 të nxjerrë nga MASHT, si dhe Vendimit të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës 01/33 e datës 29.08.2008. Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë, nga provat e administruara u vërtetuar në tërësi si e bazuar lartësia në shumën e cila është edhe e precizuar me sqarim si në precizimin e kërkesëpadisë.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar dhe atë: taksën gjyqësore për padi në vlerë prej 21.00 €, për përpilimin e padisë vlerën prej 104.00 € dhe për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumën prej 135.00 euro, apo në shumën e përgjithshme prej 260.00.-€.

Aktvendimin për përgjigje në padi të datës 11.08.2021 së bashku me padinë dhe provat, gjykata i’ka dërguar të paditurës, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 16.08.2021 (që vërtetohet nga flete kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo e njëjta nuk ka parashtruar përgjigje në padi.

Gjykata në kuptim të nenit 423 par.3 të LPK-së, shqyrtimin kryesor e mbajti në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim: Vërtetimi me numër të protokollit 148/21 i datës 18.06.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët Lleshi” në fshatin Doblilbare, Komuna e Gjakovës, Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovës në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 147/21, Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Shkolla e lartë pedagogjike në Prishtinë me numër 6931, në versionin e fotokopjuar e vërtetuar me LRP.nr.rendor 5567/2022, Licenca e mësimdhënësit me nr. 100008997 dhe Lista e pagës e lëshuar nga BRK.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,(më tutje LPK-së), arriti në përfundim se në këtë çështje juridikë kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, u vërtetua gjendja faktike si në vijim:

Nga Vërtetimi me numër të protokollit 148/21 i datës 18.06.2021, i lëshuar nga SHFMU “Dëshmorët Lleshi” në fshatin Doblilbare, Komuna e Gjakovës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi P. N. për periudhën prej datës 18.04.2017 deri me datë 31.12.2020 në institucionin e lartcekur arsimor ka punuar gjithsej 44 muaj pune.

Kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Gjakovës në versionin e fotokopjuar me numër të kontratës 147/21 gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi P. N. është në marrëdhënie pune në Institucionin Arsimor SHFMU “Dëshmorët Lleshi”, në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, si mësimdhënës i lëndës Teknologji – TIK – Fizikë.

Nga Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Shkolla e lartë pedagogjike në Prishtinë me numër 6931, në versionin e fotokopjuar e vërtetuar me LRP.nr.rendor 5567/2022, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi me datë 21.05.1990 ka përfunduar studimet në shkollën e lartë pedagogjike të lartcekur dhe ka marrë titullin arsimtar i arsimit politeknik.

Nga Licenca e mësimdhënësit me nr. 100008997, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka licencë të rregullt dhe të karrierës, e lëshuar me datë 26.12.2012 dhe skaduar me datë 26.12.2017.

Nga Lista e pagës e lëshuar nga BRK, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi, pagën bazë e ka në lartësi prej 421.00 euro dhe të njëjtit i është paguar shtesa në emër të kualifikimit SHLP në shumën prej 41.04 euro.

Nga të gjitha faktet dhe provat e administruara, për gjykatën nuk ishte kontestuese se paditësi është mësimdhënës në SHFMU “Dëshmorët Lleshi”, në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës. Ndërsa kontestuese ishte baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj, përkatësisht nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 sepse kërkesa për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit për vitin 2020 mbulohet nga kontrata kolektive e datës 18.04.2017. Në dispozitat e nenit 7 par.1 nën par. 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, parashihet që *“me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.2. Mësimdhënës me shkollë të lartë pedagogjike dy vjeçare 19% të pagës bazë”*. Në këtë

drejtim, gjykata nga administrimi i provave, ka vërtetuar faktin se paditësi është i kualifikuar si arsimtar i arsimit politeknik, rrethanë kjo e provuar nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës - Shkolla e lartë pedagogjike në Prishtinë. Në anën tjetër nga licenca e mësimdhënësit ka rezultuar se i njëjti ka licencë të rregullt dhe të karrierës. Ndërsa, nga lista e pagave – BRK për paditësin, provohet fakti se i njëjti ka pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe mbi bazën e kualifikimit, ka pranuar shtesën në shumë prej 41.04 euro. Mirëpo, në përputhje me nenin 7 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, paditësit i takon e drejta e kompensimit në lartësi prej 19% të pagës bazë apo shuma prej euro 79.99 euro. Duke qenë se paditësit në emër të kualifikimi nga paga bazë i është paguar vlera prej 41.04 euro për çdo muaj, gjykata erdhi në përfundim se paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri me datë 31.12.2020, apo për 44 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumë prej 38.95 euro për çdo muaj, në shumën e përgjithshme prej 1,713.80 euro për këtë kriter të kompensimit.

Po ashtu, duhet theksuar se përkundër faktit se licenca e paditësit e lëshuar më datën 26.12.2012, e njëjta ka skaduar me datën 26.12.2017, mirëpo me Udhëzimin Administrativ 5/2017, Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, në nenin 33 par.1 nën par.1.1. përcaktohet që vazhdohet për pesë vite licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014, në rastin konkret licenca e paditësit skadon me datën 26.12.2022.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në “Gazetën Zyrtare” të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësve, të iu paguajë vlerën e aprovuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detajisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 449 dhe 452 par. 1 të LPK-së, me ç‘rast paditësit iu pranua shume e përgjithshme e shpenzimeve në vlerë prej 259.00.-€. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20,00€ (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore) duke mos i njohur shumën prej 1,00 euro në emër të taksës gjyqësore, pasi që nuk ka dëshmi për pagesën e të njëjtës shumë, për përpilimin e padisë shuma prej 104.00.-€, si dhe përfaqësimin e të autorizuarës së paditësit në një seancë shumë prej 135.00.-€, (të parapara sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës).

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 të LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1041/21, me 26 gusht 2022.

Gj y q t a r e,
Mirjeta Shala

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.